VENDIM
Nr. 48, datë 24.3.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SOLARIS POWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pika 1 dhe 3, 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.3.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Solaris Power" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Solaris Power" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Solaris Power" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 447 prot., datë 17.2.2020, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "Solaris Power" sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 13.6.2019, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

- Objekt të veprimtarisë së saj shoqëria "Solaris Power" sh.p.k. ka tregtimin e energjisë.

- Aplikimi i shoqërisë "Solaris Power" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" "e", "f" dhe "g") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti, si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- formati i aplikimit sipas kërkesave të pikës "a", "b" dhe "c" të këtij neni është plotësuar pjesërisht;

- germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit).

Për sa i takon përfaqësuesit ligjor, shoqëria ka përcjellë në ERE prokurën e posaçme në formatin fotokopje, ndaj do t'i kërkohet që të sjellë këtë akt përfaqësimi sipas formës së përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores së licencimit.

Neni 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germa "d" (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria)

Në aplikimin e bërë nga shoqëria mungon vërtetimi i prokurorisë për administratorin e shoqërisë, si dhe vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin ligjor. Ky dokumentacion do t'i kërkohet shoqërisë të depozitohet në ERE jo me vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.

- germa "e" (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse).

Shoqëria nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores dhe do t'i kërkohet plotësimi i këtij dokumentacioni.

Neni 9, pika 3: Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "c" (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit)

Shoqëria nuk ka përcjellë dokumentacion që vërteton aftësinë ose mbështetjen financiare të tij për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Do t'i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës.

Neni 9, pika 4.8: Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike

- germa "a": Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në GWh sipas viteve

Shoqëria nuk ka paraqitur parashikime të tilla, ndaj do t'i kërkohet të depozitojë këtë informacion në ERE.

- germa "b": Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. Shoqëria nuk ka paraqitur të dhëna në lidhje kapitalin financiar, ndaj do t'i kërkohet të paraqesë në ERE dokumentacionin e nevojshëm për këtë kërkesë të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Solaris Power" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Subjekti aplikues ka detyrimin për të paraqitur, jo më vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19, vërtetimet e përcaktuara ne nenin 9, germa d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti